



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2362/6 Prot.

Patos, më 04/09/2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 3 SHTATOR 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve, Njësia Administrative Zharrëz

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjese publike me temë: “Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, administrator i njësisë administrative Zharrëz, rreth 19 pjesëmarrës (banorë dhe kryetarë të fshatrave)

Takimin hapet nga sekretare e Këshillit znju. Refaela Xeba

Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Sekretare e Këshillit
znj. Refaela Xeba**
Dëgjese publike me temë:
**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës Fiskale
2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**
Shtator 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të bërë një rishikim të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe për të rishikuar ndryshimet e Paketës Fiskale 2026. Ju ftoj të ndjekim prezantimin e ekzekutivit.

Drejtor e Zhvillimi Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj—përshëndetje të gjithëve! Jemi këtu për të prezantuar ndryshimet që do të bëhen në paketën



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

fiskale. Në raport me pjesën e taksave ngelemi në nivelin e njëjtë si në vitet e kaluara. Natyrisht kemi pjesën e taksës së ndërtesës, pjesën e taksës së truallit, tokën bujqësore, taksë tabele që është për biznesin. Të gjitha këto do të ngelen në nivele të njëjta. Taksa e truallit për biznesin ka qenë 15 l/m² dhe do të ngelemi në nivelin që kemi qënë. Taksa e tabelës është sipas metrave katror dhe taksa e tokës bujqësore është sipas sipërfaqes. Lidhur me pjesën e tarifave nga ana jonë janë shqyrtuar dhe do të merren në konsideratë sipas edhe mbetjeve. Janë edhe elementët si ndriçimi që kanë kosto dhe detyrimisht këto shërbime i rrisin këto tarifa. Për të lehtësuar po shikohen edhe variante të tjera me operatorët të cilën normalisht kanë objekt aktiviteti dhe kryejnë operacione të tilla të mbledhjes dhe riciklimit të këtyre mbetjeve. Pra sipas Plani të Menaxhimit të Mbetjeve 2025-2030 janë parë elementët që do të lehtësojnë pjesën e tarifave duke qënë se është një fushë që do krijoj të ardhura për operatorët dhe këto të ardhura do ndikojnë në lehtësimin e tarifave për konsumatorët familjar duke mos rënduar edhe pjesën e bizneseve. Aktivitetet e biznesit mbi fazën e formës së organizimit të tyre natyrisht që gjenerojnë mbetje në sasi të ndryshme dhe për këtë do bëhet një rishikim dhe do grupohen këto biznese mbi bazën e sasisë që gjenerojnë për mbetjet. Pjesa e tarifave do ngelet e hapur për diskutim. Taksat do qëndrojnë me ligjin dhe paketën fiskale që kemi patur.

Kryetar i Fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- përshëndetje! Për pjesën e tokave të pavaditshme, a shikohet taksa që duhet paguar? Këto toka nuk kanë kushte për vaditje.



**Kryetar i Fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”**

Shtator 2025

Drejtori Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj– Pjesa e kategorizimit të tokave bujqësore nuk përfshin rishikim të taksës. Pra VKM nuk merr në



**Drejtor,
z. Çajup Refitaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

konsideratë nëse toka është e vaditshme, nën ujë etj por parashikon elementët që ndikojnë në prodhimtarinë e sipërfaqes bujqësore. Pjesa e ujitjes do të jetë e parashikuar në buxhet se si ndërhyet. Kjo është një skenë që natyrisht tarifohej.

Kryetari i bashkisë Patos, z. Fation Duro- përshëndetje! Për sa i përket tarifave për mbetjet



**Kryetari i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

ne po shikojmë një mundësi që besojmë do ta arrijmë këtë vit, pasi kemi një statistik se sa mbetje prodhojnë bizneset. Këto biznese nuk mund të tarifohen njëllëj, por të kategorizohen në bazë të mbetjeve që prodhojnë.

Përfaqësues nga biznesi, z. Medi Kurteshi- Lidhur me taksat ne si biznes nuk kemi asnjë problem pasi këto taksa janë të përballueshme nga ana jonë dhe nga ana e bashkisë kemi pasur gjithmonë ndihmë dhe mbështetje. Unë do të doja të bëja kërkesë si biznes për buxhetin në fakt, nqse është e mundur që rruga të shtrohet. Ne si biznes kemi nevojë për shtrimin e rrugës pasi është në gjendje të keqe. Rruga na vështirëson edhe transportin dhe punën.



**Përfaqësues nga biznesi
z. Medi Kurteshi
Dëgjesë publike me temë:**

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”
Shtator 2025**

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Në të gjithë njësinë administrative Zharrëz do të vijohet me shtrimin e rrugëve gjatë këtij viti. Janë shumë rrugë që janë parashikuar për tu



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e PBA-
së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

shtruar. Nuk e di nëse do të mund të ndërhyjmë në të gjithë gjatësinë e rrugës që është te sektori 6, por pjesërisht do ndërhyet. Kjo do të filloj në 6- mujorin e parë të vitit të ardhshëm. Gjithashtu janë disa segmente në Verbas dhe nuk besoj se do ngelen pa shtruar. Mund të ngelet ndonjë degëzim i vogël. Rruga e Belinës është rruga më problematike në të gjithë njësinë administrative Zharrëz. Është futur në buxhet për vitin tjetër dhe kostoja është pak e lartë për ta përballuar që këtë vit. Për vitin tjetër do e shikojmë si mundësi që ta mbyllim për vitin e ardhshëm.

Kryetar i fshatit Sheqishte, Z. Afrim Grëmbi- Ne kemi një problem me rrugën te qendra shëndetësore në Sheqishte. Kemi edhe problem me pemët dhe insektet. Gjithashtu edhe ndriçimi, duhen edhe 5 lampa në Sheqishte.



**Kryetar i fshatit Sheqishte
Z. Afrim Grëmbi**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”**

Shtator 2025

Kryetar i fshatit të Ri, z. Bexhet Rredhi- Në qoftë se është e mundur të rruga e Belinës të bëhet një karikim i lehtë më çakull.



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Bexhet Rredhi**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Do të përpiqemi ta karikojmë me çakull rrugën e



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Belinës që të lehtësoj sado pak kalimin. Për sa i përket pemëve dhe insekteve ka qënë i vështirë menaxhimi për shkak të motit të nxhtë që bëri. Kurse ndriçuesat kanë ngelur edhe shumë pak të cilat do përdoren për qytetin. Jemi përpjekur të marrim sa më shumë ndriçuesat. Gjithashtu dua të shtoj që do të fillojnë edhe dy stacionet e pompimit.

Kryetar i fshatit Belinë, z. Agim Grëmi- A keni ju një plan për vjeljen e taksave pasi ka



**Kryetar i fshatit Belinë
z. Agim Grëmi**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

familje që kanë shumë vite të larguar dhe janë debitor. Është e vështirë të vilen këto taksa dhe duhet gjetur një mekanizëm për të vjel këto taksa. Sepse ata përdorin dhe vaditjen e tokave dhe përsëri tarifat nuk i paguajnë.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Zgjidhje ka sepse ne mund të përdorim dhe



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”**

Shtator 2025

gjobat lidhur me këto familje, por kjo është pak e vështirë për tu aplikuar. Megjithatë ajo çfarë mund të bëjmë është që të mbahen në kontroll këta persona.

Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, z. Çajup Refitaj- Për pjesën e tarifimit duke qënë se pjesa më e madhe e juaja ishin mosha të mëdha ne kemi asistuar edhe stafin dhe kemi qënë gjatë gjithë kohës në terren prezent dhe janë lëshuar faturat. Kjo ka të bëjë me pjesën se është një shërbim që kërkon bashkëpunim dhe nga ana juaj.



**Drejtor
z. Çajup Refitaj**

Dëgjësë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve
të projekt dokumentit për hartimin e
PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin
2026”**

Shtator 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Dua të shtoj edhe investimin në shkollën “Sotir Çapo” që do të filloj rikonstruksionin dhe vitin tjetër do të filloj mësimi në atë shkollë. Është projekti më i bukur dhe do të jetë shkolla më e bukur në Patos.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjësë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Elmira Rama- Doja të shtoja që te shkolla e Frashërit ka nevojë për ndërhyrje në rrjetin elektrik sepse në dimër kanë nevojë për ngrohje.



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Elmira Rama**

Dëgjësë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Ne kemi disa soba me dru, për shkollat nuk pranojnë të kenë sob me dru për ngrohje. Ne do të shikojmë t’ju ndihmojmë me ngrohjen.

Banor i Zharrëzës, z. Fuat Bani- përshëndetje! Fillimisht unë dua t'ju përgëzoj për punën tuaj. Ne jemi një lagje prej familjesh këtu në Zharrëz afër njësisë dhe nuk kemi asgjë në lagje. Ne nuk kemi një lëshues energjie dhe nuk arrijmë të ndezim dot asnjë frigorifer sepse është një linjë shumë e dobët. Të gjithë fermerët dolën keq me prodhimin. Kjo lagje nuk ka asnjë llamb dhe është rruga shumë errësirë. Banorët dalin shëtitje në dark, por rruga nuk ka ndrita. Gjithashtu ferrat e rrugës janë pa pastruar, kosha nuk ka, ujë nuk kemi as për vadtje dhe as ujë të pijshëm. Rrugët e parcelave janë shumë të ngushta. Edhe kanalet kanë nevojë për pastrim.



**Banor i Zharrëzës
z. Fuat Bani
Dëgjesë publike me temë:**

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Kryetari i bashkisë Patos, z. Fation Duro- para disa muajsh po të bëje një krahasim me të tre njësitë në gjendje më të keqe ishte qyteti brenda. Po të dalësh në Patos në brendësi të



**Kryetari i bashkisë Patos, z. Fation
Duro
Dëgjesë publike me temë:**

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

lagjeve gjendja është shumë e keqe dhe nuk ka asnjë rrugë të dalësh nga shtëpia. Kishte rrugë mbas pallatit Kulturës që makina nuk kalonte fare. Në qoftë se do të futeshe të Përroi që kemi 1 vit e gjysëm që punojmë çdo ditë dhe nuk po mbarojmë dot, ishte gjendja shumë e keqe. Lagjja e Re e cila po punohet aktualisht nuk ka asnjë rrugë fare dhe nuk kalon dot dhe ne po punojmë aty. Lagjja Naftëtari tani është duke u mbyllur e gjitha. Lagjja “29 Marsi” gjithashtu po punohet dhe po mbyllet pasi aty edhe kanalet ishin plot me ujëra të zeza. U bë rruga dhe trotuari. Jemi munduar të bëjmë shumë punë dhe të ndërhyjmë në Patos. Do ndërhyjmë edhe të Përroi që kalon në Dukas. Edhe për KUZ edhe pse nuk është kompetencë e jona ne përsëri

jemi munduar të ndërhyjmë. Shumë punë jemi munduar t'i mbyllim me punëtorët tanë për të zvogëluar kostot dhe për të rritur sasinë e shërbimeve. Edhe varrezat do sistemohen në gjithë Zharrëzën. Gjithashtu kemi edhe disa rrugë parcelash për të hapur në njësinë Zharrëz. Edhe ujërat e zeza në Verbas janë tre segmente që do bëhen nga bashkia.

Kryetar i fshatit Zharrëz, z. Abedin Hoxha- Rrugët e brendshme të Zharrëzës janë



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

problem. Ne kemi problem me varrezat, trotuaret, prerjen e pemëve në varreza dhe prerjen e pemëve në rrugën nacionale dhe krasitjen e tyre. Për sa i përket urës që kemi aty ka probleme dhe rruga aty. Kontrollin e trotuareve në pjesët që ka ndërhyrë ujësjellsin na ka lënë shumë probleme duke lënë shumë defekte. Rruga Belulaj dhe Dinallarëve ka ndonjë planifikim?

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Për sa i përket pemëve se kuptoj pse doni ti prisni fare. Pemët janë të rëndësishme. Ura nuk është pronë e bashkisë dhe nuk ndërhyjmë dot. Rruga Belulaj është e parashikuar për vitin tjetër.

Kryetar i fshatit të Ri, z. Irakli Zarka- të kanali kullues të rruga te trotuarit duhet një ndërhyrje urgjente pasi është bllokuar me ferra. Rruga e re është çarë fare anë e Përroit nga Novosela.



**Kryetar i fshatit të Ri
z. Irakli Zarka**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i ndryshimeve të
projekt dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Do ta verifikojmë këtë problem dhe do të ndërhyjmë. Nëse nuk kemi diçka tjetër unë do ta deklaroja të ezauruar këtë dëgjese publike. Ju falenderoj për pjesëmarrjen tuaj!



**Kryetar i fshatit Zharrëz
z. Abedin Hoxha**

Dëgjese publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba